REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE
Nr.Prot 713 Datë. 3.8.16

Miratohet

GENTIAN SALA

KRYETAR

UDHËZIM
PËR
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË SHQYRTIMIT TË DOKUMENTACIONIT DHE MËNYRËN E SHQYRTIMIT DHE VLERËSIMIT TË APLIKIMEVE

Korrik 2016

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë rregullat për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit si dhe procedurat e shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikimeve për marrje autorizimi ose rinovimin të tyre, të aplikimeve për zgjerim të zonës së ofrimit të shërbimit, të aplikimeve për rinovimin e licencave të transmetimit audio dhe audiovizive, nga Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit.

Neni 2
Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë Udhëzim do kenë të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 97/2013, "Për mediat audiozivive në Republikën e Shqipërisë".
2. Në kuptim të këtij Udhëzimi , termi:
   a. **"Subjekt/et"** do të përdoret për çdo person fizik dhe/ose juridik, që aplikon në AMA për marrje licence dhe/ose autorizim, rinovimin e licencës dhe/ose autorizimit.
   b. **"Komisioni"** është Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit.
   c. **"Aplikim"** është aplikimi, ose kërkesa që bën subjekti për marrje licence dhe/ose autorizim, rinovimin e licencës dhe/ose autorizimit.
   d. **"Kryetari"** është Kryetari i Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA)
   e. **"Sekretari i Komisionit"** është sekretari i AMA-s ose nëpunësi i caktuar nga Kryetari ose Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 3
Komisioni

1. Komisioni është i vetmi organ përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve të subjekteve.
2. Komisioni vepron në bazë e për zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive", i ndryshuar dhe rregulloreve të miratuara në dhe për zbatim të tij.

Neni 4
Konflikti i interesave

1. Kryetari dhe anëtarët e Komisionit kanë detyrimin të shmangin çdo konflikt ndërmjet interesit të tyre privat dhe interesit publik në kryerjen e detyrës sipas legjislacionit përkatës në fuqi.
2. Kryetari dhe anëtarët e Komisionit, me t'u njohur me urdhrin për ngritjen e komisionit, ka detyrimin të informojnë menjëherë Kryetarin në rast të një dyshimi për një konflikt interesi dhe të zbatojnë urdhrat e tij.

Neni 5
Përbërja e Komisionit

1. Komisioni është struktura *ad hoc* që ngrihet me urdhër të Kryetarit dhe përbëhet nga Kryetari i Komisionit dhe Drejtorët e drejtorive të AMA-s.
2. Kryetar i Komisionit mund të jetë çdo funksionar i kabinetit, nëpunës i lartë i administratës i autorizuar në urdhër prej Kryetarit, përfshirë dhe zëvendëskryetarin e AMA.
3. Komisioni asistohet nga sekretari, i cili është përgjegjës për mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes dhe numërtimin e dokumentacionit të depozituar në aplikim.
4. Komisioni shqyrton dhe vendos për aplikimet në përputhje me kërkesat e ligjit dhe akteve nënligjore të nxjerra në dhe për zbatim të tij.

Neni 6
Mbledhja e Komisionit

1. Komisioni mblidhet me urdhër të Kryetarit, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të aplikimit pranë AMA.
2. Nëpunësi i arkivë-protokollit, në rast të depozitimit të aplikimeve për marrje licence dhe/ose autorizim, rinovimin e licencës dhe/ose autorizim, njofton brenda 1 dite pune Kryetarin, i cili përcjellë dosjen pranë Drejtorisë Juridike dhe Licencave.
3. Drejtoria Juridike dhe Licencave përgatit urdhërin për ngritjen e Komisionit brenda 1 dite pune pas njoftimit për depozitimin e aplikimeve.
4. Urdhëri për ngritjen e Komisionit i njoftohet nga sekretari i Komisionit, në formë shkresore dhe elektronike, anëtarëve të paktën 2 (dy) ditë përpara datës së mbledhjes.
5. Sekretari i Komisionit njofton urdhrin e Kryetarit edhe anëtarëve të AMA të cilët ftohen për të marrë pjesë ditën e zhvillimit të mbledhjes së Komisionit.
6. Nëpunësi i arkivë-protokollit në datën dhe orën e caktuar të mbledhjes së Komisionit i përcjell Komisionit, të gjithë aplikimet e depozituara, të cilët duhet të jenë të pahapur.
7. Në përfundim të mbledhjes, Sekretari i Komisionit, pasi numërton dokumentacionin pjesë e aplikimit, ua përcjell dosjen e aplikimit pranë anëtarëve të Komisionit për përgatitjen e relacioneve të vlerësimit.
8. Sekretari i Komisionit mban dosjen e aplikimit deri në përfundimin e gjithë procesit të shqyrtimit dhe përgatitjes së dokumentacionit për Këshillin e AMA-s.

Neni 7
Procedura e shqyrtimit nga Komisioni

1. Përpara fillimit të mbledhjes, anëtari i Komisionit të Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme verifikon nëse subjekti ka paguar Detyrimin Financiar për Përpunimin e Dokumentacionit (DFPD) dhe njofton Komisionin.

a. Në rast se subjekti nuk e ka paguar DFPD, hapja e aplikimit të subjektit, sipas pikës 7/1 të këtij neni, shtyhet deri në kryerjen e pagesës në fjalë.
b. Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme njofton, brenda 5 (pesë) ditësh nga mbledhja, subjektin aplikues për kryerjen e pagesës.

2. Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme njofton Kryetarin e Komisionit dhe Drejtorinë Juridike dhe të Licencave, në rast se subjekti kryen pagesën e DFPD-së dhe aplikimi i subjektit verifikohet, në parim, në mbledhjen e radhës të Komisionit.
3. Komisioni verifikon nëse subjekti aplikues ka plotësuar rregullisht formularin e aplikimit, për marrjen e autorizimit dhe/ose licencës për të cilin shfaqet interes si dhe për rinovimin e licencës dhe/ose autorizimit, i cili është i publikuar në faqen zyrtare të AMA-s, apo i disponueshëm pranë zyrave të AMA.
4. Nëse Komisioni konstaton se aplikuesi nuk ka plotësuar formularin e aplikimit me të gjitha të dhënat e kërkuara në të, nuk hap dosjen e aplikimit duke njoftuar subjektin aplikues mbi pasaktësitë e plotësimit.
5. Drejtoria Juridike dhe e Licencave njofton subjektin jo më vonë se 2(dy) ditë pune nga dita e zhvillimit të mbledhjes, mbi pasaktësitë në plotësimin e formularit, duke i kërkuar plotësimin e të dhënave brenda 5 (pesë) ditësh nga marrja e njoftimit.
6. Komisioni pas hapjes së dosjes së aplikimit, bën një vlerësim paraprak të dokumentacionit të paraqitur. Në përfundim të verifikimit, në parim, të aplikimit, të të dhënave dhe të dokumentacionit shoqërues të subjektit, pas nënshkrimit të procesverbalit të mbledhjes, secili prej anëtarëve përgatit relacionin e vlerësimit sipas kompetencës dhe kërkesave të drejtorisë që përfaqëson, sipas neneve 8 – 12 të këtij udhëzimi.
7. Në relacionin e vlerësimit secili nga anëtarët e Komisionit plotëson tabelën përmbledhëse të kritereve të vlerësimit duke shënuar përkrah përmbushjen, mospërmbushjen e tyre apo propozimin për plotësim me dokumentacion të mëtejshëm.
8. Relacionet e vlerësimit përgatiten dhe i dorëzohen Drejtorit të Drejtorisë Juridike dhe të Licencave, në formëshkresore dhe elektronike, jo më vonë se 3 ditë nga marrja në dorëzim përkundrejt nënshkrimit në procesverbalin e vlerësimit të aplikimit.
9. Brenda 5 (pesë) ditëve nga mbledhja e relacioneve vlerësuese të të gjithë anëtarëve, Drejtoria Juridike dhe Licencave përgatit relacionin përmbledhës, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit.
10. Në rast se në përfundim të vlerësimit në tërësi të aplikimit, rezulton se aplikimi i subjektit nuk është i plotë, Komisioni i propozon Kryetarit lënien e një afati, jo më pak se 15 ditor subjektit, me qëllim plotësimin e aplikimit me dokumentacionin e kërkuar.
11. Kur Kryetari pranon propozimin e Komisionit ai miraton lënien e një afati jo më shumë se 15 ditë subjektit aplikues. Në këtë rast Drejtoria Juridike dhe e Licencave ngarkohet për njoftimin e subjektit.
12. Në zbatim të pikës 11 të këtij neni, Drejtoria Juridike dhe e Licencave njofton subjektin jo më vonë se 2 (dy) ditë pune nga miratimi, prej Kryetarit, i lënies së një afati për plotësim të dokumentacionit.

13. Drejtoria Juridike dhe Licencave njofton Kryetarin e Komisionit, jo më vonë se 3 (tre) ditë pune nga data kur subjekti aplikues depoziton kërkesën për plotësim aplikimi, ose nga data kur subjektit i ka përfunduar afati i lënë dhe ai nuk ka depozituar asnjë kërkesë për plotësim aplikimi.
14. Në mbledhjen e tij të radhës, Komisioni merr në shqyrtim dhe vlerëson nëse subjekti aplikues ka plotësuar ose jo të metat e aplikimit. Shqyrtimi dhe vlerësimi i dokumentacionit plotësues bëhet sipas pikave 6 – 9 të këtij neni.
15. Drejtoria Juridike dhe e Licencave përgatit relacionin përfundimtar përmbledhës të vlerësimit, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit.
16. Relacioni përfundimtar përmbledhës i vlerësimit, së bashku me gjithë praktikën e subjektit aplikues, si dhe propozimin përkatës të Komisionit në lidhje me aplikimin e subjektit, i paraqitet AMA-s në mbledhjen e tij të rradhës.

Neni 8
Dizpozita të fundit

Çdonjëra prej Drejtorive ka të drejtën të kërkojë aplikimin e nenit 56/9 të Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë".

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë.